



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 112/02-15813
Dt: 01.04.2026

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me caktimin e Sektorit përgjegjës për lëshimin e vërtetimit të obligimeve të shfrytëzimit të pronës komunale, me datë 01.04.2026 merr këtë:

V E N D I M

1. Caktohet Sektori për Menaxhimin e Pronës Komunale, përgjegjës për lëshimin e vërtetimeve për palët e interesuara që nuk kanë obligime financiare ndaj Komunës së Gjakovës për shfrytëzimin e pronës komunale.
2. Sektori i përshkruar si në pikën e parë (1) të këtij vendimi, duhet të ndërmerr veprime konform dispozitave ligjore në fuqi, duke lëshuar vërtetim për palët e interesuara sipas kërkesës, pas verifikimit në regjistrat e obligimeve të shfrytëzuesve të pronës komunale.
3. Sektori duhet të ndërmerr veprime që të sigurojë informacione për obligimet e papaguar në të gjitha Drejtoritë, Njësitë dhe Sektorët përkatëse, me qëllim që të lëshohet vërtetimi për palët që nuk kanë obligime të papaguara të shfrytëzimit të pronës komunale.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Sektorit për Menaxhimin e Pronës Komunale
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

